



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Auditim performance: "SHËRBIMI PARASHKOLLOR"

Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas shkresës nr. 553, datë 19.06.2013, njoftim për fillim auditimi, ndërmori auditimin me temë "Performanca e shërbimit parashkollor". Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Bashkinë e Tiranës, Qendrën Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë, pasi këto janë institucionet që kanë përgjegjësi direkte në ofrimin e këtij shërbimi. Ministria e Shëndetësisë është përfshirë në këtë auditim në rolin e institucionit hartues të udhëzimeve, protokolleve kombëtare si dhe manualeve për ushqyerjen e shëndetshme tek fëmijët. Pas përfundimit të punës paraprake audituese më datë 10.10.2013 u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr 553/5, datë 27.03.2014 iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve dhe palëve të interesit. Raporti përfundimtar është hartuar pasi janë shqyrtuar observacionet dhe shpjegimet e dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim si dhe pas konsultimeve me palët e interesit.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të Ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997, "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000:

K O N K L U D O I:

Për Bashkinë e Tiranës, Qendrën Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë:

Qyteti i Tiranës ofron një shërbim të plotë parashkollor, me kopshte dhe çerdhe të shpërndara në të gjithë territorin e saj. Ky shërbim ka njohur rritje vit pas viti në të gjithë elementët përbërës të tij. Për këtë arsye, vlerësojmë punën e kryer nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë shërbim, të cilët nëpërmjet veprimtarisë së tyre kanë ndihmuar mjaft në funksionimin normal e të përmirësuar të institucioneve parashkollore: Bashkia e Tiranës, Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë. Në ditët e sotme, institucionet parashkollore sigurojnë një gamë të gjerë shërbimesh për fëmijët dhe prindërit e tyre. Kopshtet dhe çerdhet, përveç qëndrimit të fëmijëve, përkujdesjes ndaj tyre dhe edukimit, ofrojnë edhe shërbimin ushqimor dhe atë shëndetësor e psiko-social.

Godinat e trashëguara vite më parë të kopshteve dhe çerdheve kanë qenë të pakta në numër, pa sistem ngrohjeje qendrore dhe mjaft të amortizuara. Edhe pse të pamjaftueshme për të përballuar kërkesat e shumta, ndërtimet e reja apo rikonstruksionet e kryera vitet e fundit nga Bashkia dhe vënia në shfrytëzim e tyre nga QEZHEF, kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e kushteve të akomodimit të fëmijëve.

Veprimtaria e shërbimit parashkollor bazohet në standarde sasiore dhe cilësore të përcaktuara qartë, të cilat janë të përafërta me ato të aplikuara në vendet e OECD. Këto standarde janë hartuar nga Bashkia dhe Ministria e Arsimit me ndihmën e UNICEF dhe shtrihen që nga fëmijëria e hershme e deri tek arsimi parashkollor. Nga ana tjetër, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar e publikuar udhëzues të shumtë që promovojnë ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve. Vendosja e këtyre standardeve përbën një zhvillim cilësor pozitiv dhe një hap përpara në këtë drejtim, por arritja e plotë dhe realizimi konkret i tyre, kërkon përmirësime të ndjeshme në disa fusha të shërbimit parashkollor.

Por përtej arritjeve të shumta, sot shërbimi parashkollor përballet me sfida dhe me problematika të larmishme, duke filluar që nga aksesit i kufizuar në kopshte dhe çerdhe e deri tek cilësia e diskutueshme e shërbimeve që ato ofrojnë.

Auditimi është fokusuar në aspektet strukturore e organizative të shërbimit parashkollor, të cilët janë të matshëm dhe përcaktohen nga një kuadër rregullator i caktuar.

Pas analizimit të treguesve të cilësisë së shërbimit parashkollor u arrit në përfundimin se: ***Edhe pse është bërë shumë në drejtim të hartimit të standardeve sasiore dhe cilësore, përkujdesja ndaj fëmijëve të çerdheve dhe veçanërisht të kopshteve ka vend për përmirësim të mëtejshëm.***

Nga auditimi i performancës së këtij shërbimi u konkludua:

- Kërkesa për të ndjekur shërbimin parashkollor është shumë më e lartë sesa oferta nga sektori publik, veçanërisht për kopshtet. Në treg janë të pranishëm edhe kopshtet private, por ndikimi i tyre në zbutjen e diferencës kërkesë-ofertë është i vogël. Në këto kushte, ku nevojat janë sa dyfishi i kapaciteteve, çdo fëmije i është cënuar hapësira individuale e përcaktuar në standardet përkatëse. Hapësirat e ngushta, nuk i lejojnë ata të lëvizin lirisht dhe të zhvillojnë potencialin e plotë. Duhet theksuar edhe se rritja e popullsisë gjatë këtyre viteve nuk është shoqëruar me përmirësimin progresiv të infrastrukturës së shërbimit parashkollor dhe si pasojë gjendja e kopshteve dhe çerdheve rezulton e mbipopulluar. Vonesat në shtimin e kapaciteteve akomoduese përmes ndërtimeve të reja, kanë përkeqësuar gjendjen ekzistuese.
- Megjithëse Shqipëria ka vendosur teorikisht standarde korrekte dhe të krahasueshme me ato të vendeve të OECD, një tjetër standard i cënuar është raporti edukatore-fëmijë, i cili është një tregues sasior i frekuencës së kontakteve ndërmjet tyre dhe i matjes së cilësisë së shërbimit parashkollor.
- Shërbimi ushqimor përgjithësisht është i organizuar mirë, por produktet ushqimore të menuesë së ofruar nuk janë plotësisht në përputhje me udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.
- Shërbimi shëndetësor dhe ai psiko-social nuk janë në nivelin e duhur dhe kanë nevojë për ristrukturime dhe rikonceptime të mëtejshme.
- Rëndësi në këtë auditim i është kushtuar edhe aksesit në arsimin parashkollor të fëmijëve 5-6 vjeçarë i cili është ende i ulët në vendin tonë. Pothuajse në të gjithë vendet e Europës, edukimi parësor fillon me një vit përgatitor parashkollor, i cili është i detyrueshëm, ndërkohë që aktualisht në Shqipëri fëmijët e moshës 5-6 vjeç kanë të drejtën, por jo detyrimin, të ndjekin një vit përgatitor parashkollor. Ndërkohë, programi ndërkombëtar PISA i vlerësimit të

nxënësve që kryet nga OECD ka konkluduar se nxënësit 15-vjeçarë që kanë ndjekur të paktën një vit edukimi parashkollor, kanë pasur rezultate më të mira në vitet pasuese të shkollës, sesa ata që nuk kanë ndjekur asnjë vit edukimi parashkollor, madje edhe pasi është marrë në konsideratë kuadri i tyre social-ekonomik.

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi Kryetari i KLSH-së:

V E N D O S I:

I. Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit “Performanca e Shërbimit Parashkollor”, të ushtruar në Bashkinë e Tiranës, Qendrën Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë.

II. Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkojë marrjen e masave për sa vijon:

1. Në mbështetje të objektivave të saj strategjike dhe duke mbajtur në konsideratë Objektivat Zhvillimorë të Mijëvjeçarit të OKB, MAS të konsiderojë përfshirjen e nxënësve 5-6 vjeçarë në arsimin e detyruar me synim rritjen e aksesit në arsimin parashkollor. Ky shërbim mund të ofrohet në kopshte ose në klasat përgatitore pranë shkollave 9-vjeçare, nëse këto të fundit janë të konceptuara sipas standardeve të kopshtit, *trajtuar më hollësisht në faqen 16 të Raportit të Auditimit.*

Në vazhdimësi

2. MAS dhe Bashkia e Tiranës, në kushtet e kapaciteteve të kufizuara, të implementojnë një sistem regjistrimi në institucionet publike parashkollore i cili i jep prioritet pranimit të fëmijëve nga familjet në gjendje ekonomike nën mesataren, si një masë afatshkurtër për të reduktuar momentalisht kërkesën e tepërt, *trajtuar më hollësisht në faqet 13-14 të Raportit të Auditimit.*

Brenda vitit 2014

3. MAS nëpërmjet mekanizmave të përshtatshme, të intensifikojë politikat inkurajuese ndaj kopshteve private, si një alternativë efektive për zgjerimin e kapaciteteve dhe reduktimin e diferencës kërkesë-ofertë për shërbimin parashkollor, *trajtuar më hollësisht në faqen 14 të Raportit të Auditimit.*

Në vazhdimësi

4. MAS dhe Bashkia e Tiranës, të marrin në konsideratë kërkimin e burimeve alternative të financimit për shërbimin parashkollor, siç mund të jetë nxitja e partneritetit me donatorët vendas apo të huaj, *trajtuar më hollësisht në faqen 14 të Raportit të Auditimit.*

Në vazhdimësi

5. Instrumentet vendore të planifikimit, duhet të vlerësojnë nivelet e ardhshme të popullsisë, nëpërmjet studimit të kushteve dhe tendencave aktuale të urbanizimit të Tiranës, me qëllim plotësimin e nevojave me infrastrukturë parashkollore për njësitë bashkiake të cilat kanë numrin më të lartë të fëmijëve 0-6 vjeç, *trajtuar më hollësisht në faqet 19-20 të Raportit të Auditimit.*

Në vazhdimësi

6. Plani i ri i Përgjithshëm Rregullues i Tiranës, duhet të marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbimin parashkollor, duke përcaktuar sheshe të përshtatshme për ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve të reja, si në periferinë e qytetit ashtu edhe pranë qendrës së Tiranës, ku dendësia e popullsisë është rritur ndjeshëm, *trajtuar më hollësisht në faqet 19-20 të Raportit të Auditimit.*

Në vazhdimësi

7. Duke synuar një zgjidhje më afatgjatë për infrastrukturën e munguar të shërbimit parashkollor, Bashkia e Tiranës të konsiderojë mundësinë e integritit të kopshteve dhe çerdheve në katet e para të ndërtesave të reja, *trajtuar më hollësisht në faqet 19-20 të Raportit të Auditimit.*

Në vazhdimësi

8. Bashkia e Tiranës të marrë masa për të zhvendosur kabinën elektrike dhe shtyllat e tensionit të lartë larg territorit të kopshtit Sauk, duke i kushtuar rëndësinë e duhur sigurisë dhe jetës të fëmijëve, *trajtuar më hollësisht në faqet 26-27 të Raportit të Auditimit.*

Menjëherë

9. QEZHEF të konsiderojë mundësinë për të publikuar shumën totale që do të prokurohet për ushqimin, pa detajuar vlerën për secilin lot por vetëm sasinë e nevojshme. Në këtë mënyrë, do të mund të arrihet vlera më e mirë e parave, pasi praktika e publikimit të fondit limit për çdo lot orienton operatorët drejt çmimeve, *trajtuar më hollësisht në faqen 27-28 të Raportit të Auditimit.*

Brenda vitit 2014

10. Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me ASHR të shqyrtojë mundësinë për të kryer një shpërndarje të studiuar të burimeve njerëzore që mbulojnë shërbimin shëndetësor në kopshte dhe çerdhe, në mënyrë të tillë që ky shërbim të jetë i pranishëm edhe në 16 kopshtet dhe 5 çerdhet ku aktualisht mungon, *trajtuar më hollësisht në faqen 30-31 të Raportit të Auditimit.*

Brenda vitit 2014


11. QEZHEF, të shqyrtojë mundësinë për të modifikuar planin e punës së psikologëve dhe punonjësve socialë, duke i ndarë ata sipas njësive bashkiake, me qëllim që një psikolog dhe një punonjës social të jenë të fokusuar gjithmonë në të njëjtat çerdhe, *trajtuar më hollësisht në faqet 34-36 të Raportit të Auditimit.*

Brenda vitit 2014

12. DAR Tiranë të optimizojë shpërndarjen e psikologëve në kopshte, duke mbajtur në konsideratë numrin e fëmijëve të regjistruar në çdo kopsht si dhe duke i kushtuar rëndësi kopshteve me numrin më të lartë të fëmijëve me nevoja të veçanta, *trajtuar më hollësisht në faqet 34-36 të Raportit të Auditimit.*

Në vazhdimësi

Grupi i auditimit
Evis Çela
Yllka Dede
Blerina Kërçuku



Drejtori
Rinald Muça

Tiranë, Maj 2013